



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 4153/Prot.
16

Tiranë, më 22/012013

U R D H E R

Nr. 05 datë 22/01 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë”

K O N S T A T O V A

Pranë kontrolluesit “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” një grup kontrolli i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbështetur në urdhrin nr. 202 datë 07/11/2012 të Komisionerit ka zhvilluar kontrollin administrativ me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e të dhënave që përmbajnë vendimet gjyqësore bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, në lidhje me:
 - Qëllimin, Proporcionalitetin dhe Përshtatshmërinë;
 - Informimin e subjekteve të të dhënave;
 - Cilësia e të dhënave;
 - Të dhënat sensitive;
 - Veprimtaritë e përpunuesve në lidhje me procesin, nëpërmjet kontraktimit e delegimit të të dhënave;
 - Ruajtja e konfidencialitetit dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi relacionin e kontrollit administrativ, procesverbalin e konstatimit të kontrollit administrativ, provat e administruara gjatë ushtrimit të kontrollit vëren se:

Kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” disponon “Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore”, në lidhje me regjistrimin, shpërndarjen sipas gjyqtarëve, përcaktimin e datave të gjykimit, hedhjen e procesverbalit të gjykimit dhe publikimin e vendimit të gjykimit në internet përmes portalit <http://www.gjykata.gov.al>.

Nga kontrolli administrativ rezulton se; “Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” është i lidhur me portalin <http://www.gjykata.gov.al>. Ky portal menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë dhe lidhja (konfigurimi) me këtë portal është realizuar nga pala e tretë, një kompani e cila realizon shërbimet teknike të “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore”, konfigurimit të lidhjeve dhe sinkronizimit me serverin në ambientet e AKSHI_t si dhe të mirëmbajtjes teknike të serverëve. Komunikimet realizohen nëpërmjet “Rrjetit Virtual Privat” VPN (Virtual Private Network). Ky portal është aktiv dhe në të figuron i lidhur kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë”, pavarësisht se në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ në këtë portal nuk shfaqen të publikuara vendime gjyqësore të kontrolluesit.

Nga kontrolli administrativ rezulton se pavarësisht se “Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” administrohet dhe mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë, vendimet gjyqësore hidhen në sistem nga punonjës (sekretaria gjyqësore) e kontrolluesit “Gjykata e rrethit Gjyqësor Korçë”, ashtu si kundër janë në dosjen fizike pa bërë asnjë ndërhyrje në të, rrjedhimisht ato publikohen ashtu siç janë në dosjen fizike të çështjeve pa marrë masat e duhura për bërjen anonime të të dhënave personale të subjekteve që përfshihen në këto vendime.

Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimi nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” theksojnë se;

Të dhënat personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor, bëhen publike vetëm nëse nga ky publikim nuk cenohen interesat legjitimë të subjekteve të të dhënave. Subjekti i të dhënave personale informohet mbi të dhënat e tij, të cilat do të publikohen me initiale ose të koduara në faqen zyrtare në internet, me qëllim bërjen e tij të pidentifikueshëm.

Përpara publikimit dhe vënies në dispozicion të publikut, personat përgjegjës kujdesen për të siguruar që të dhënat personale në vendimet gjyqësore të jenë të sakta dhe të plota.

Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat

në mbrojtje të privatësisë, gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me initiale ose kodohen, në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave. Gjatë publikimit të vendimeve civile familjare, gjeneralitetet e palëve ndërgjyqëse paraqiten me initiale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i rrethanave që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të tyre ose personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore, si dhe i të dhënave, mbi dhënien e mendimit të fëmijës, mbi detyrimin ushqimor, mbi takimet e të miturit me prindërit, kohën dhe vendin e takimit, mbi raportin e psikologut, po kështu dhe në vendimet e tjera administrative penale etj. etj.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se duke bërë publike (të pa anonimizuar) të dhënat personale të subjekteve të përfshira në këto vendime shkelet

privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale, nuk respektohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta këto të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për “Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”, ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale” neni 2 i tij ku thuhet ... “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private”, si dhe udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrotjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, duke konsideruar kështu paligjshmërinë e publikimit të këtyre të dhënave personale që mbartin këto vendime gjyqësore.

Komisioneri për Mbrotjen e të Dhënave Personale vlerëson se, është shumë e rëndësishme të marrin të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrotjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”.

Nga kontrolli administrativ rezultoi gjithashtu se; kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” nuk disponon asnjë dokument apo rregullore të shkruar për mënyrën përdorimit të “Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore”(ICMIS), lidhur me procedurat dhe detyrat që duhet të kryejnë punonjësit (sekretaria gjyqësore) gjatë hedhjes në sistem të vendimeve apo çdo dokumenti tjetër që mbart të dhëna personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore, duke mos zbatuar nenin 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”...*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.*

Rezultoi se kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” nuk ka kontratë dhe asnjë dokument të shkruar ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e kompanisë e cila menaxhon anën teknike të “Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore”, si dhe kompanisë që menaxhon faqen e tyre zyrtare në internet.

Përfaqësuesit e kompanisë mirëmbajtëse nga ana teknike të programit kryejnë procedurat e tyre në rastet kur thirren nga punonjësit e Kontrolluesit ose nga përfaqësuesit e Ministrisë të Drejtësisë, nuk ka asnjë dokument ku të pasqyrohet puna dhe procedurat që kryhen nga këto punonjës përgjegjës për mirëmbajtjen teknike të sistemit. Kontrata sipas deklarimeve të përfaqësuesve të Kontrolluesve është e lidhur midis kompanisë mirëmbajtëse dhe Ministrisë të Drejtësisë, por ato nuk disponojnë asnjë kopje të kësaj kontrate. Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” nuk ka marrë masa teknike të përshtatshme në ambientin ku është vendosur serveri (rregullim i temperaturës, masa kundër zjarrit, mungesë e një serveri sekondar), për të garantuar disponueshmërinë e sistemit ICMS.

Këto konstatime konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim i kushteve kritereve që parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neni 27 si dhe udhëzimet nr. 2 “Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale”, nr.15 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, nr. 21 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

URDHEROJ

Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” **Kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë”**

1. Të bëjë menjëherë pezullimin e publikimit të vendimeve gjyqësore dhe çdo dokumentacioni që mbart të dhëna personale (të pa anonimizuar), të subjekteve të të dhënave personale, në portalin www.gjykata.gov.al, deri në marrjen e masave ku publikimi i tyre, të bëhet me të dhënat personale të anonimizuar, konform kërkesave të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 15 datë 23/12/2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”
2. Të marrë masat organizative:
 - Të hartojë kontratë të shkruar me palën e tretë, në funksion të mirëmbajtjes, të “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” (ICMIC).
 - Të hartojë deklaratë konfidencialiteti me palën e tretë dhe punonjësit e saj të cilët vihen në dijeni me të dhënat personale gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, për të ruajtur konfidencialitetin e këtyre të dhënave.
3. Të marrë masat teknike:
 - Për të siguruar “integritetin” dhe “disponueshmërinë” e “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” (ICMIC), të dhënave si dhe proceseve të punës.
 - Për të siguruar procedura standarde për ruajtjen (backup) e të dhënave dhe sistemeve në një vend të sigurt dhe jashtë ambientit në të cilin punohet.
 - Për ruajtjen e temperaturës konstante në bazë të kritereve teknike për funksionimin e një dhome serveri (server-room).
 - Për të siguruar komunikimin të sigurt dhe të kontrolluar me anë të postës dhe të shmangi mundësinë e përdorimit të postës elektronike personale të punonjësve.

1. Kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë” mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lenë ne këtë urdhër.
2. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

